

Ermira YMERAJ

Elira SMAKAJ

FJALA DHE FALJA NË KANUN. FJALËT URTA SI ÇËSHTJE TË PAREMIOLOGJISË

UDC 39(=18)(049.3)

Abstrakti: *Fjalët e urta si çështje të paremiologjisë, mveshen me vlera filozofike, sociologjike, juridike, etike, etno-historike. "Urtësia" e tyre në përbajtje, ka vlerën e një ligji të shkruarnë nene të veçanta të sistemeve juridike të njojuranga shoqëria njerëzore shqiptare. "Njeriu lidhet prej fiale, kurse kafsha prej briri". Tekstet të tilla i quajmë fjalë të urta, ato janë të shkurtëra, koncize dhe të imprehta, janë kontekste semantike që theksojnë situata përkatëse. Si thënie janë autonome dhe kanë kuptim të plotë, por gjithmonë të përbledhura në një kontekst diskursiv dhe të integruar me tekste të tjera. Këto thënie kanë vlerë ose kuptim paremologjik vetëm nëse ato bazohen në situata konkrete ose në realitetë historike. Me fjalë të tjera, fjalë të urta quhen të tilla, vetëm kur një komunitet i njeh ato dhe u jep atyre fuqi e pushtet ekspresiv dhe komunikues. Në kanun thëniet të tilla, dalin si krijime metaforike popullore që përbajnë një mësim moral dhe shprehin besimet dhe idetë e një komuniteti.*

Fjalët kyçe: Paremiologjia, fjalët e urta, Kanuni

Në kohën e mungesës së shtetit, për të ruajtur vlerat kulturore si fenë, gjuhën, zakonet, rendin, Malet e Shqipërisë, përpiluan akte normative, duke shmangur nënshtimin legjislativ të të huajit. Kanuni¹ i Lekë Dukagjinit i strukturuar në: 12 libra, 24 krye dhe 159 nyje, numëron 1263 nene. Te libri i gjashtët, *Fjala dhe Falja*² dhe Libri i shtatet, *Fjala e Gojës*, fjalët në Kanun si psikë filozofike e jetës shoqërore trajtohen bashkë mefjalëtë urta, si nene të veçanta, me vlerën e sentencave juridike.

Ato përbajnë trashëgiminë autentike të tij, janë mendimi racional, i gjykuar i drejtë në ushtrimin e lirisë së individit që jeton në një bashkësi shoqërore formim kulturor të ngjashëm meatë të Rilindjes Evropiane, për të drejtat natyrore të njeriut, shfaqur në sentencën: "Je i lirë me mbajtë burrën t'ande, je i lirë me u shburrnue"³.

Fjalët e urta si çështje të paremiologjisë⁴, mveshen me vlera filozofike, sociologjike, juridike, etike, etno-historike. "Urtësia" e tyre në përbajtje, ka vlerën e një ligji të shkruarnë nene të veçanta të

¹Kanun është quajtur têrësia e parimeve, e institucioneve dhe normave tradicionale, që ka vepruar në Shqipëri, në mënyrë të pavarur nga juridiksioni shtetëror, qoftë nga ai turk qoftë nga ai i qeverive që erdhën më vonë. Për Shaban Sinanin, Kanuni i Lekë Dukagjinit, është vepër monumentale e mendësisë dhe e psikologjisë shqiptare. Sinani, Shaban. Mitologji në Eposin e Kreshnikëve, Studim Monografik (Botimi i tretë), Naimi, Tiranë, 2011, f. 11.

²Kanuni i Lekë Dukagjinit përbledh e kodifikue prej A. Shtjefen Konst. Gjegjov, O. F. M, Shkodër 1933, f.100: Krye i gjashtëmbdhjetë. E folmja, e falmja. Neni i tetëdhjetë e katërt, "E folmja asht në fund të kuletës" f.101, Neni 85 – 517, 519, "Fala s't'a fala. Kanuja s'e kapë", "Kanuja thotë ftyren e vrugnueme në daç laje, në daç zezoje edhe ma".

³ Po aty, f.101, Neni 85- 518.

⁴Paremiology është shkenca që studion proverbat, ku çdo fjali transmeton njojuri bazuar në përvojën. Paremiologjia merret me proverba, si informacion i akumular në shumë vite të historisë, sociologjisë, letërsisë, gjuhës, fesë, etj.. Shumë shpesh një proverb vjen nga një shkurtim i një histori apo një përbërje tradicionale. Në një proverb shprehet besimi e supersticioni me vlerë alegorike, për të ilustruar metaforikisht argumentet tona, me saktësi gjuhësore është një model efektiv komunikimi metaforik. Paremia, ka një kuptim më evokues; në thelb ekspozon shkurtimisht këshilla ose një mendim të zbatueshëm në jetën praktike. Disiplina që studion Paremia përdor mjete filologjike, gjuhësore dhe antropologjike. Termi vjen nga paremiology, paroim

sistemeve juridike të njohuranga shoqëria njerëzore shqiptare. “Njeriu lidhet prej fjale, kurse kafsha prej briri”¹. Tekstet të tilla i quajmë *fjalë të urta*, ato janë të shkurtëra, koncize dhe të mprehta, janë kontekste semantike që theksojnë situata përkatëse. Si thënë janë autonome dhe kanë kuptim të plotë, por gjithmonë të përbledhura në një kontekst diskursiv dhe të integruar me tekste të tjera. Këto thënë kanë vlerë ose kuptim paremologjik vetëm nëse ato bazohen në situata konkrete ose në realitetë historike. Me fjalë të tjera, fjalë të urta quhen të tilla, vetëm kur një komunitet i njeh ato dhe u jep atyre fuqi e pushtet ekspresiv dhe komunikues. Në kanun thëniet të tilla, dalin si krijime metaforike popullore që përbajnë një mësim moral dhe shprehin besimet dhe idetë e një komuniteti.

Nëse ndalemi në ngarkesën juridike të fjalëvetë urta popullore si: “Gjaqet i la Leka një për një” dhe në parathëniene Gjergj Fishtës², pohohet se fjala “ndëshkim” nuk është shenjë e barbarisë apo e kanibalizmit të shqiptarëve. Ndëshkimi (la vendetta) në Kanun për një vrasje, është një vendim me vlerësimin juridik të një vendimi gjykate, ku gjaksori dhe cubi sipas kanunit janë të mbërapsht e të dënueshëm. Nëse i referohemi rastitë krimit për gjak, fjalë, falja dhe fjalët e urta janë parandaluese: “Kush e jep fishekun”, përcakton si përgjegjës për gjakderdhje atë që ka kërkuar një gjakmarrje, “kush prin”, bashkëpunëtorin që e drejton, “Gjaksin ruaje e mos e përcjell faqe shoqit të shpisë së të vravit”, paralajmëron të papërgjegjshmit që marrin për sipër të mbrojnë gjaksin. Edhe termat “dorasi” dhe “dorëzania”, janë fjalë me vlerë parandaluese. Dorasi është vrasësi³, ndërsa dorëzania, institucioni i zgjidhjes sipas rasës.

Kultura ndërtohet e studiohet mbi simbole, edhejeta në kanun ndërtohet dhe funksionon përmjet simboleve. Një simbol⁴ është një objekt, fjalë, apo veprim me një kuptim të përcaktuar kulturor, që përfaqëson diçka tjetër, me të cilën ai nuk ka marrëdhënie natyrore. Mund të themi se simbolet janë arbitrale (sepse nuk kanë asnjë lidhje të nevojshme me atë që simbolizojnë/simbolizohet), janë të paparashikueshëm, dhe të ndryshëm. Për shkak se simbolet janë arbitrale, është e pamundur të parashikohet se si një kulturë e veçantë simbolizon diçka⁵. Në vazhdën e arsyetimit mund të themi se simboli shërben si ndërmjetësuese mes formës së thënës dhe dimensionit të mendimit. Nëse qëndrojmë në kufijtë e një filozofie reflektive, mund të pretendojmë se Fjala⁶ në kanun, posedon identitetin subjektiv brenda një shoqërie, në kuptimin e sintezës pasive, është takimi me të pavetëdijshtmen (e pavullnetshmja absolute) që na shpie në besimin se subjekti zotërohet jo në mënyrë të drejtë përdrejtë dhe të menjëhershme, por përmes një rruge më të gjatë përballjeje me burimet simbolike që kultura vë në dispozicion. Përmes imazheve të dendurapësohet një devijim në botën simbolike, (***mort s'ban, gjuha asht e tulit dhe gjithçka bluen, goja nuk vulos***), subjekti (fjala),

grebisht (paroimia) që do të thotë “duke thënë, ose thënë që devijon nga rruga e zakonshme e të folurit” ose “thënë simbolike, figurativisht” ose “metaforë e zgjeruar dhe përpunuar.” Ndërsa thëniet kalojnë nga një gjuhë në një tjetër, proverbat janë ekskluzive e secilës gjuhë. Mund të themi se thëniet janë krijime me origjinë metaforike popullore që përbajnë një mësim moral dhe shprehin besimet a idetë e një komuniteti.

¹Po aty, f.160, Neni 141 -1002, Parim i kanunit asht: “Plak mbi plak, gjyq mbi gjyq e be mbi be kanuja nuk ban”.

²Shtjefën Gjeçovi, Kanuni i Lekë Dukagjinit, me parathëni të Gjergj Fishtës, Shkodër, Shtypshkronja franceskane, 1933, f. XIII-XIX.

³ Po aty, f.150, neni- 922. Mikun e prem', armët e gruen e dhunueme, kanuja s'i perket. Nuk lejohet të vritet hasmi nëse: Gjatë asaj kohe është ndër besë; rrugës është me fëmijë ose me gra; është i paarmatosur. Neni -855 thotë: “*Me çue gjind për besë asht kanu; me dhanë besë është detyrë e burni;*”

⁴Simbol do të quajmë çdo strukturë të kuptimitës, sepse çdo simbol është një shenjë apo një shprehje e veçantë gjuhësore që shpreh, përcjell, ose komunikon një kuptim.

⁵ “Simboli të bën të mendosh”, - shprehet Paul Ricoeur. Simboli i jep kuptimin asaj që është për t'u menduar dhe mbi të cilën duhet menduar, sepse duke u nisur nga prirja, kuptohet pozicioni.

⁶Po aty, neni 86 - 520. *Gjuha asht e tulit e gjithshka bluen.*

mund të aftësohet për të kuptuar veten dhe botën. Me ngarkesë paremiologjikeajo shpreh krijimtarinë e vërtetë të njeriut, vetë simboli shpreh nevojën e ekspozimit të fjalës, nevojën e shprehjes përmes fessë, filozofisë dhe psikës. Një simbol është një shenjë, por jo çdo shenjë është një simbol. Shenjat e thjeshta mbajnë vetëm kuptime të manifestuara, simbolet, në të kundërtën, shprehin kuptime shumë më të thella, kuptime të fshehta pas atyre që shihen në sipërfaqe. Simbolet dhe interpretimi, janë koncepte reciproke. Me këtë pohojmë pse simboli është ai që i jep dritë të menduarit.

Po, çfarë është interpretimi¹? Përqëndrohem i te Fjala dhe falja në kanun: Fjala e gojës, Nye i tetëdhetëgjashtët, “*Fjala mort s'ban*”. -“*Shtriga në gjak nuk bjen*”. “*Goja, s'get kend në gjak*²”, bën që të mendosh se kultura jonë është e dallueshme dhe në vijueshmëri të kushteve jetësore e veçuar për një mjedis kulturor, ku truri njerëzor ishte i aftë të mendonte në mënyrë simbolike, të kuptonte botën e jashtme thellë dhe të ndërtonte mbrojtjen e saj, për tu mësuar nga anëtarët e tjerë të grupeve sociale autoktone ose të anëtarësise me efekt irregullues, unifikues, progresist dhe parandalues. Mbështetur ter relativizmi deskriptiv³ apo përshkrues ne zbulojmë mënyrat e ndryshme të të menduarit të këtij grupi kulturor si dhe standardet e arsyetimit rreth tyre. Ne konkludojmë sipas kësaj logjike vlefshmërinë e parimeve dhe praktikave të këtij grupi kulturor. Objekti i studimit të relativizmit përshkrues janë deklarimet empirike, fakt ky që mund të provokojë mbështetjen ose jo të tyre. Ende gjyket se të vepruarit është i vetmi veprim që ndodh midis njerëzve pa ndërmjetësinë e sendeve⁴, ndaj kanuni shprehet se: *Fjala e gojës s'eme hin në vesh, e i treti e përdoron për rrënim të kuj, un rri e tallem*⁵. *Fjala e eme në shkaktoftë vrasë të përgjegjme un rri e zgërdhijem, nuk mund të më kapë kush për punë të liga, qì i shkaktoj goja e eme. Aj, qì shkon tuj njellë e tuj hapë fjale të kqija e gërgasa herë për njanin herë për tjetrin, me gojë të kanunit thirret “Argat i keq”. A fola a s'fola, goja nuk vulos gja.- Fjalët e sterqive kanuja s'i merr para sypsh.*

Memorizimin e historisë së botës, në ditët e sotme, e bën gjuha, sipas A. Jakllarit, në planin metodologjik, gjuha jo vetëm është instrument komunikimi me autoktonin, por edhe objekt i kërkimit antropologjik, pra gjuha është një fakt me interes antropologjik, jo vetëm për atë që na thonë autoktonët, por edhe për atë që autoktonët e thonë me njëri – tjetrin.

Për Koliqin, kultura e shqiptarëve dhe trashëgimia e mishëruar në të, nuk është trilluar a shpikur aty pari, por është mësuar, transmetuar nga anëtarët e grupit social që i përkasin edhe pse kjo lloj trashëgimie, është modifikuar në çdo aspekt, falë simboleve. Qëllimi i etnosemantikës apo antropologjisë konjiktive që e fokuson kuptimin e gjuhës në lidhje me rrëthanat e ndryshme shoqërore t'saj është gjetja e kuptimit të fjalëve, fjalive e frazave dhe përcaktimi i mënyrave se si anëtarët e shoqërive të tjera i organizojnë sendet, ngjarjet dhe sjelljet sipas këtyre bashkësive gjuhësore. Edhe gjuhëtari, Seit Mansaku, gjykon se gjuha mbetet si njëri nga faktorët më të

¹Riceour, Paul. Op, Cit. f. 13. Ricoeur deklaron: Interpretimi (...) është vepër e mendimit, i cili konsiston në deshifrimin e domethënieve të fshehta në kuptime të qarta, të dukshme dhe në shpalosjen e nivelit të kuptimit të nënkuptuar në kuptimin e fshehur. Me fjalë të tjera, interpretimi është procesi i deshifrit të kuptimeve të simboleve. Ai lind nga nevoja për të nxjerrë kuptimin “jashtë” nga simbolet. Qëllimi i tij është të zbulojë domethënien e fshehtë të simboleve të pazbuluara, t'i sjellë në dritë, t'i deshifrojë, dhe t'i kuptojë.

²Po aty, f. 102.

³Relativizmi deskriptiv e anon peshën e tij në çështje filozofike sociale që kanë të bëjnë me kuptimin dhe interpretimin e kulturave të huaja ose të epokave të largëta historike.

⁴Platoni, Republika, Phoenix, Botimi i parë, Tiranë, 1999, fq 30.

⁵Po aty, neni521 / 522 / 523 / 524.

rëndësishëm për formimin dhe përcaktimin apo karakterizimin e një bashkësie etnike¹. Pra, gjuha luan rol të rëndësishëm për formimin e një etnosi dhe zhvillimin e tij dhe, më pas, bëhet një faktor themelor i identifikimit të një bashkësie etnike apo të një shoqërie të dhënë, siç është rasti i shoqërisë sonë. Gjuha identifikon dhe identifikohet me kombin. Kombi, si i tillë, është një bashkësi etnokulturore, gjuhësore e territoriale. Në greqisht termi ka në bazë një lidhje gjaku, ndërsa në Shqipëri fjala komb ka kuptim të pare, nyje, lidhje, bashkim, të materializuara ndërmjet gjuhës².

Në parathënie Fishta sharroi karakteristikat e psikës së tij në të mirë e në të keq ashtu si në gjaqe, hakmarrje, turpërim, dhe nënvizoi, se këto të fundit s'ishin personale, por përkundra ishin vetëmbrojtje për vend e Komb.³ Ndaj simbolet kombëtare si flamuri, territori gjeografik, zakonet, doket dhe traditat janë identifikuase. Brenda botës kuptimore të fjalës dhe faljespër malësorin pasqyruar në kanun, dallojmë burrërinë, mikpritjen, bujarinë, besën, urtinë, virthyte të larta, që ruhen e përcillen si kode të shenjta, nëpërmjet sjelljes dhe veprimtarisë së njeriut, si dhe realizimin e mbijetesës sinkronike ediakronike të tij. Kanuni i malevet të Shqypnis nuk e veçon njerin prej njerit “shpirt për shpirt se dukën e fal Zoti”. Shenjtëria e kodeve të kanunit pranohej dhe nga priftërinjtë e famullive duke i bekuar brenda kupolës së kishës. Fakti që kisha katolike shqiptare në këtë kohë pranoi bashkëjetesën brenda famullive të tyre të gjakmarrjes në stilin e ciklit të vazhdueshëm, ndonëse në vetvete, gjakmarrja binte në kundërshtim me porosinë e Krishtit për të falur kundërshtar. Kanuni ishte edukata dhe ndërgjegjja juridike e malësorëve, zgjedhja e përbashkët e mënyrës së jetesës. Mbi bazën e tij ndërtohej e ndryshohej morali. Në gjithë nyjet e tij, kanuni, përshkrohet nga fjala e këruar, fjala shpërbëhej në 12 shtylla kryesore, të cilat ndërtonin jetën dhe veprimtarinë jetësore të maleve të Shqipërisë, në fillimin e shekullit XX. Ky kod i normuar bashkëjetese duhet të ketë zotëruar më parë një kulturë të ngulitur etnike. Sepse, një mënyrë bashkëjetese e pranuar pa kushte nga të gjithë, kërkon shekuj të tërë të rregullohet me norma të njësuara. Nëse e pranojmë këtë origjinë, do të nxirnim si konkluzion se Kanuni i Lekë Dukagjinit, shpreh ekzistencën e një jete urbane qytetare dhe të një ndërgjegjeje bashkësie të hershme. At Zef Plumit, duket se është një ndër përsiatësit e origjinës së lashtë të kanunit, përderisa thotë se kush njef kuvendet e Malsorve t'onë, din deri ku arrin zotsija e tyne me derme parashtesat e njâj kundërshtari me gjuhë që therë e pret.

Kështu, formulat e betimit nuk zënë në gojë hyjnité me emër⁴. Betimet, betë për qiel e dhe, *për kët' gur, për kët' peshë, për kët' bukë*, shprehnin besime mitologjike dhe jo shenjorë të qenësishëm të fesë katolike. Kanuni ishte jo vetëm e drejta e rregullimit të bashkëjetesës, por edhe e drejtëfamiljeje, e drejtë civile, e drejtë pune e procedure, një ansambël i vërtetë drejtësie, ku përcaktohesin në mënyrën më të sintetizuar raportet e njeriut me familjen, me fisin, me miqësinë, me flamurin e me atdheun. Te shqiptarët nuk vihet re përqasja me librat e shenjtë si formë ekzekutimi apo reflektimi, qoftë kjo edhe bibla. Ndërsa në bibl "Fjala ishte e para", në këtë nye "fjala", merr tipologji tjetër

¹Mansaku, Seit. Antropologjia e shqiptarëve, Shoqata Antropologjia Shqiptare, Konferanca e Parë, Gjuha si tipar themelor i identitetit etnik te shqiptarët, Tiranë, 24 - 26 tetor 1997, f. 23.

² Sami Frashëri, në "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë", f. 104. Duke parandierë gjuhën si simbolin autohton, identifikues e të lidhur ngushtësisht me ekzistencën jo vetëm territoriale të shqiptarëve, shprehet se: *Kombëtë janë si pishqiti, që hanë njeri tjetrin. Mjerë kush ësht' i dobët!* Frashëri, Sami. Kombëri i Shqipëtarëve, Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë. Mendime për shpëtim të mëmëdheut nga reziket që e kanë rrethuare, Botuar për herë të parë në Bukuresht në vitin 1899. Biblioteka: Botime të veçanta, redaktor i përgjithshëm Lloshi. Xhevat, Logosa, Tiranë, 2004. f. 86 / 88. Besa dhe kombësia, marrëdhënia me armët, gjuha dhe kombi. f. 67.

³Po aty, f. 127, neni 735. *Dami ka çmim, por jo giobë.* neni 739. *Dami ka çmim, por jo pushkë.* Liber i tetet, "Ndera", Krye i shtatemdheter, f.111, neni 593: Neni 594: *I miri e i keqi kanë një çmim; Kanuni i mban për burra:* " Në kandar të vet secili peshon katërgind derhem".

⁴Sinani, Shaban. Mitologji në Eposin e Kreshnikëve, Studim Monografik (Botimi i tretë), Naimi, Tiranë, 2011, fq. 15.

komunikimi mes njerëzve, sepse kategoritë themelore të etikës së shqiptarit mbeten nderi, dinjiteti, respekti, mirësjellja, mikpritja etj., norma të përcaktuara nga trashëgimia dhe amaneti i të parëve, në shumicën e rasteve nuk përkojnë as me mësimet e fesë.

C'natyrë ka fjala? Cilat janë prirjet e faljes? Kanuni i Malevet të Shqipnis nuk e veçon *njerin prej njerit. Shpirt për shpirt se dukën e falë Zoti*¹.

Parimet themelore të Kanunit, ishin parime morale. *I pari është nderi*². Krahas hakmarrjes qëndron falja dhe pse hakmarrja është futur thellë në jetën e këtyre njerëzve, më shumë se sa vdekja e të afërmit të tyre, i mundon gjallja e vrasësit ende të pandëshkuar. Falja dhe hakmarrja mund të trajtohen si pika kulmore të filozofisë ekzistenciale³. Ekzistenca paraprin thelbin që krijohet nga veprimet, aktet që individi i zgjedh vetë. Ai zgjedh të krijojë thelbin e vet. Pra, shqiptari zgjodhi të krijonte kanunin e tij, ta vinte atë në jetë e në të shumtën e herës të identifikohej me të. Veprimet dhe mos veprimet për kanun, jo vetëm paraprin thelbin e shqiptarit, por e shndërruan vetë atë në thelb, esencë, domethënë. Fishta⁴ pohon se: *njeri ka tre rode t'mira mi tokë: jetën, gjâni e nderen e t'gjitha ligjët e kanùnet e njerzimit janë n'projtim t'kytne trî t'mirave. Nji popull, pra, qì me ligjë e kanùne t'veta i pruen kto trî rode t'mirash t'njerit nuk mûnd t'quhet barbar, pse zëhet qì fuqit e veta don me i perdonue për t'mirë t'jetës s'shoqnueshme. E kshtû, na tuj marrë n'kujdes se ligjët e kanùnet e Shqypnisë, janë vëndue për me pruejt jetën, (kanë marrë vendim për të ruajtur) gjân e nderen e nierit t'shoqnueshem, mûnd t'thomë me gjith arsy, se populli shqyptar nuk âsht nji race barbare e poshtme n'Europe*⁵. Në një barazi e liri të tillë, për sigurinë, për mirëqenien dhe nderin e të gjithëve dhe të secilit, është e nevojshme një ndjenjë e lartë përkrahëse e individëve në bashkësinë ku bëjnë pjesë, dhe përveç kësaj, një nivel i lartë përkushtimi e besueshmërie për përbushjen e zotimeve në marrëdhënet e përditshme në mes të personit dhe bashkësisë, që mbështetet e sigurohet nga parimi i besës dhe i paktit të burrave, me anë të institucionit të fjalës ose premtimit të dhënë. Kanuni siguronte vazhdimësinë e këtij botëkuptimi të jetës shoqërore dhe përkrahte institucionet themelore në të cilat, ky botëkuptim, gjente realizim në tërsëi e në veçanti.

Besa, si fenomen nuk mund të përkufizohet thjesht si mbajtee fjalës së dhënë, nisur kjo nga dallimi mes fjalës së dhënë me lidhjen e një kontrate gojore, dhe besës si kategori elementare dhe fondamentale të lidhjes me besë. Me kultin e besës është i lidhur kulti i fjalës së dhënë, ose, kulti i nderit. Ekzistenca e kësaj lekseme nuk është provuar në shumë gjuhë të botës. Në shumë raste, në përkthime prej shqipes, fala besë, trajtohet si dukuri e botës shqiptare, pra si albanizëm. Besa, ose kulti i fjalës së dhënë, lidhet me burimin e mitin biblik të fjalës: *Në fillim qe fjalë!*, pra më parë se të ishte shkrimi, zyrtarizimi, shteti, popujt, njeriu, ishte fala, oraliteti. Ky kult madhështor, tek shqiptarët ruajti gjurmën e burimit. Duke iu referuar kësaj gjurme, Koliqi, vëren dhe këshillon në mënyrë retorike: *E kur nji popull mban të shenjtë doken e besës, përse të mos ketë mundësi me ia mbrrijtë nji ndërgjegje të plotë kombëtare me bashkimin vëlla me vëlla?*⁶. Leksema besë, në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe është përkufizuar si zotim solemi për të vepruar së bashku për një qëllim, fala e nderit që jepet për të përkrahar dikë, ose për t' u lidhur me të. Fala e dhënë për diçka të rëndësishme, fala e nderit

¹Gjeçovi, Shtjefën. K. Kanuni i Lekë Dukagjinit. Kuvendi, Lezhë, 1998, Hyrje.

²Dedaj, Ndue. Kanuni dhe koha e sotme : mbi kuptimin e së drejtës zakonore dhe të shtetit ligjor, Mirdita, Rrëshen, 2001, f. 21.

³Sartre, Jean-Paul. Ekzistencializmi është humanizëm, Phoenix, Tiranë, 1997, f. 12.

⁴Gjergj Fishta, Përndritje, Tiranë, 2000. f. 12

⁵Kanuni i Lekë Dukagjinit : vepë postumë, Shjfëfën K. Gjeçovi (Përmbledh e kodifikue prej Gjergj Fishta), Shtypshkronja Françeskane, Shkodër, 1933, Parathënje

⁶Fjalime nga Fishta, Harapi, Koliqi, Redaktoi dhe pajisi me shënimë, Tonin Shiroka, Shtëpia Botuese Uegen, Tiranë, 2009, Fjalim i mbajtur në Kolegin Saverian në vitin 1930 nga Koliqi, të titulluar, Puna si burim i qytetnisë dhe perparimit të popullit, f. 79.

për ta plotësuar medoemos një detyrim që merret përsipër, materializohet në fjalët e urta përgjatë gjithë kanunit¹. Lidhja prej fjale: *Kali lidhet prej kapistre e burri prej fjale*, përbënte në kanun autoritetin më të lartë. Të gjitha marrëdhëniet dhe marrëveshjet, qofshin në gjini, në fis, në famulli, në bajrak apo në nivelin e bashkësisë etnike a ndëretnike, bëheshin me fjalë. *Sa ishte besa, nuk qe shkresa*. Koliqi e klasifikon besën: si *nji doke e hyjnueshme, që lulzon vetëm ndër malet dhe fushat shqiptare, me episode të thekshme e të bucura, të frymëzueme nga një poezi e thellë njerëzore e cila të lë pa mend, tuj ia vu qytetërimin bujar të zemrës së shqiptarëve të maleve të cilët nuk kanë asnje kulturë shkencore*².

¹Fjalet e urta përgjatë kanunit, f.35 “Grueja s’bjen në gjak”.-“Grueja lishon më gjak prinden”, f.40 “Kush vret vedin shkon gjak-hupës”, f.57 “Gjaja do rojë, ‘se hecë, e toka nuk luen”, f.57 “Nderat e vathit asht në kumbonë”, f.66 “Guri i kufinit ka dëshmitarë”, f.66 “Kufini i ngulun nji herë, nuk luhet ma”, f.71 “Udha e shtegu ndermjet dy megjeve lypë pashin e vet”, f.72 “Udha ndjekë dellin, e s’nalet as mund pritet” f.72 “Puna e largon udhen e madhe, porse s’mund e qesën n’ujë, ku mbytet bagtija, as në shkallë (Shkamb), ku then qafen bagtija”, f.74 “Pashtakun epe vetë, përndryshej t’ a marrin edhe me perdhuni”, f.75 “Puna e luen shtegun”, f.75 “Shkaterkzi e luen udhen”, f.77 “Farkës (si edhe Kishës, mullinit e perbujtores) s’i pritet kush mik”, f.79 “Mullisi e perbujsi do të flejë në njanin brryl, f.79 “Mullini e farka e kan me rend”, f.81 “Vija e arnajave nuk luhet e nuk ndalet”, f.81 “Plak mbi plak kanuja s’ban”, f.81 “Themeli nuk zhgulet”, f.81 “Për nji shpi s’lehet m'u tha nji katund”, f.83 “Vija e re s’mund t’mund t’ a thajë të vjetren”, f.93 “Pushka e kali e kan kuj mbë kuj”, f.95 “Kali me qira lëkuren mbë tra”, f.96 “Gja çdo gja”, f.100 “E folmjë asht në fund të kuletës”, f.100 “E folmjë asht në fund të kuletës”, f.101 “Fala, s’ta fala. Kanuja s’e kapë”, f.101 “Ftyren e vrognue me në daç laje, në daç zezoje edhe ma”, f.102 “Fjala mort s’ban”.-“Shtriga në gjak nuk bjen”.-“Goja s’qet kend në gjak”, f.104 “Ben nëgojësh kanuja as s’e pelqen, as s’e tumirë; e per të dlirun prej zhgarkimesh lypet doemos që të bahet beja mbë nji shej besimi e të perkitet me dorë”, f.105 “Ban e hup, thotë kanuja e jo ban e merr”, f.105 “Uku e lpin misht e vet por të huejin e han”, f.108 “Maja e bes asht “sedija” (S’ë dija)”, f.108 “Beja t’ a njef edhe “sedijen” (s’ë dija)”, f.108 “Beja s’ka skaj, por s’ban perbishtnime”, f.109 “Mos të ndeshtë zoti në berrejshmin, f.113 “Miku don dru”, f.113 “Bukë e krypë e zemër”, f.113 “Mikut të yemrës i lëshohet shpija”, f.113 “Mikut i lëshohet kryet e vendit”, f.114 “Buka e lan damin”, f.115 “Buka m'u gjet dreq pat thanë dikush”, f.115 “Paç e dhaç thotë kanuni”, f.115 “Miku mik; shoqi shoq”, f.120 “Dorzanë, dorëdhënë”, f.120 “N’dékët detyrsi, rrnofët dorëzani”, f.120 “Dorëyani nuk hin për me majtë në mend, por për me la”, f.121 “Dora e thatë ska uratë”, f.127 “Dami ka çmin, por jo gjobe”, f.127 “Dami ka çmin, por jo pushkë”, f.138 “Aj, që prin, e merr gjakun mbi vedi”, f.138 “Pushka e çon gjakun te shpija”, f.147 “Gjaku shkon për gisht”, f.147 “Gjak për gjak mbetë”, f.153 “Pushka njekë gjaksin”, f.153 “Pushka e parë ka gjobë”, f.154 “Kush vret vedin shkon gjak hupës”, f.156 “Dorzanë e bestar nuk hin kush ma parë”

² Fjalime nga Fishta, Harapi, Koliqi, Redaktoi dhe pajisi me shpjegjime, Tonin Shiroka, Shtëpia Botuese, Uegen, Tiranë, 2009. Fjalim i mbajtur në Kolegin Saverian nga Koliqi, 1930, Puna si burim i qytetnisë dhe përparimit të popullit, fq. 79.